



Planuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivery	28.04.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	SKPM/SHUK	2485/2022	1/3
Titull /Prot Br Prot Prot No		Shtojca Punë/ Appendo	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr.379/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1452/2020 të datës 12.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.162/2020 të datës 18.06.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „kompensim material“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1622/2020 e datës 18.06.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 14-070/01-78607/20, i datës 03.06.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, me datë 18.06.2020, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1183/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar me datë 01.07.2020, kundër Vendimit me numër 14-070/01-78607/20 të datës 03.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës për shkak të shkeljeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, Këshilli me datë 19.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e

Prishtinës, ndërsa me datë 09.07.2029, Këshilli ka pranuar nga Komuna e Prishtinës shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.08.2020 përmes shkresës me numër të protokollit 1489/2020, ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e tij të datës 18.06.2020, duke udhëzuar të njëjtin që ti ndjekë më tutje procedurat ligjore.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 12.04.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1452/2020, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit tani ankuesit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të datës 07.08.2020 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditësit të datës 18.06.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.162/2020 të datës 18.06.2020 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimi i ankesës me prova shtesë me numër protokollit 1249/2020; të datës 01.07.2020; Formulari i regjistrimit të ankesës; Vendimin me numër 14-070/01-78607/20 të datës 29.06.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës; Vendimin Nr.14-118/02-61778/20 të datës 18.03.2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; Akt emërimit 01 Nr.112-52 të datës 01.02.2017; Vendimin e datës 05.01.1982; Ankesën e datës 29.05.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin me numër protokollit 1489/2020 të datës 07.08.2020; Aktgjykimin A.nr.1452/2020 të datës 12.04.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbalin e datës 12.04.2022 i seancës mbi shqyrtimin kryesor A.nr. 1452/20; Padia e paditësit e datës 02.09.2020 e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ftesën për seancën e datës 12.04.2022; Përgjigje në padi e datës 05.04.2022 me numër protokollit 1855/2022; Autorizimi i datës 12.04.2022 me numër protokollit 2011/2022 dhe Përgjigje në ankesën të datës 09.06.2020, me numër protokollit 1187/2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e pa bazuar ankesa e ankuesit

SEPSE:

Nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së ankuesi sipas Akt Emërimit 01 Nr.112-52 të datës 01.02.2017; ka qenë i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën *Zyrtar i Prokurimit 1*. Me Vendimin Nr.14-118/02-61778/20 të datës 18.03.2020 të Kryetarit Komunës së Prishtinës ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës nga data 09.04.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e pagës përcjellëse në shumën prej një page mujore në vlerën e pagës së fundit në vlerë prej treqindpesëdhjetë e nëntë Euro e njëzetetë cent (359.28 €). Ankuesi kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë me datë 29.05.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me Vendimin me numër 14-070/01-78607/20 të datës 03.06.2020 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar. I pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar me datë 01.07.2020, për shkak të shkeljeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve

Civil dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, duke pretenduar që të njëjtit i njihet e drejta e kompensimit të tri pagave përcjellës me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë siç përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhën jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, mbi këtë bazë, Kolegji konstaton së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 09.04.2020 respektivisht në kohën kur nuk është e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Bazuar në konstatimin si me lartë, Kolegji vlerëson së Kryetari i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.14-118/02-61778/20 të datës 18.03.2020 përmes të cilit ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse në vlerën e pagës së fundit, ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 19 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *"Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.379/2022

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.